



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2022:201311

Datë: 28.03.2024

Numri i dokumentit: 05520096

C.nr.589/2022

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Avni Berisha, në çështjen juridiko-civile të paditësit B.K nga fshati Krushe e Madhe, Komuna e Rahovecit, me përfaqësues të autorizuar avokat D.M nga Prizreni, kundër të paditurës E me seli në Prishtinë, lidhur me çështjen kontestimore padi për kompensim të dëmit, vlera e kontestit 1,000.00 euro, më datë 26.03.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

KONSIDEROHET SË ËSHTË TËRHEQUR padia e paditësit B.K, nga fshati Krushe e Madhe, Komuna e Rahovecit, kundër të paditurës E me seli në Prishtinë lidhur me çështjen kontestimore padi për kompensim të dëmit, vlera e kontestit 1,000.00 euro.

Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi B.K, me përfaqësues të autorizuar avokati D.M nga Prizreni, me datë 29.09.2022 ka paraqitur në Gjykatë padi për kompensimin e dëmit, kundër të paditurës E, me seli në Prishtinë.

Gjykata gjatë shqyrtimit paraprak të padisë për kompensimin e dëmit, gjeti se paditësi nuk e ka paguar taksën gjyqësore.

Me vërejtjen për pagesë të taksës gjyqësore C.nr.589/22 të datës 05.12.2022, kjo gjykatë e ka ftuar paditësin që në afat prej 15 ditësh, ta paguajnë taksën e paraparë gjyqësore për padinë e parashtruar, me vërejtje se në rast se të njëjtën nuk e paguan do të konsiderohet se e ka tërhequr padinë.

Në shkresat e lëndës ekziston prova – fletëkthesa, se përfaqësuesi i autorizuar i paditësit e ka pranuar aktvendimin e lartcekur, me datën 09.12.2022, dhe nuk ka vepruar brenda afatit të caktuar nga Gjykata.

Duke marrë parasysh faktin se as pas aktvendimit të dërguar nga gjykata, paditësi nuk e ka bërë pagesën e kësaj takse brenda afatit të përcaktuar, ndërsa që nuk ekzistojnë kushtet për lirimin e saj nga pagesa e të njëjtës, gjykata vendosi si në dispozitiv, e në pajtim me dispozitat e nenit 253 pika 5 të Ligjit nr.03/1-006 për Procedurën Kontestimore, në të cilin nen thuhet se: “ *Në qoftë se*

*Paditësi nuk e paguan taksën gjyqësore të përcaktuar për padinë as pas vërejtjes së dërguar nga gjykata, edhe pse nuk ekzistojnë konditat për lirim nga detyrimi i pagimit të taksës gjyqësore, do të konsiderohet se padia është tërhequr ”.*

Vendimi mbi shpenzimet procedurale, që secila palë t’i bartë këto shpenzime, është marrë në kuptim të nenit 450 të LPK-së.

Prandaj, nga ajo që u tha më lartë, kjo gjykatë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, e në bazë të nenit 253 pika 5 të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC**

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil

C.nr.589/2022, më datën 26.03.2024

Gjyqtari  
Avni Berisha

**KËSHILLË JURDIKE:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit.